



REPUBLICA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivered	09-06	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtjete Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRMBHAK	2995/2021		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Anr.302/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën e datës 23.04.2021 e parashtrua përmes postës së Kosovës me numër R1449620, e regjistruar me datës 26.04.2021 me numër A.nr.302/2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë fshati Pleshin Komuna e Ferizajt, kundër organit të punësimit Komuna e Ferizajt, në çështjen juridike “Kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 09.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar si e pa lejuar ankesa me numër A.nr.302/2021 e datës 26.04.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunë të Ferizajt në pozitë “Inspektor për Inkasim të Detyruar”, në Drejtorin për Ekonomi, Financa dhe Buxhet sipas Akte Emërimit të datës 01.07.2011, me koeficient gjashtë (6), me datë 16.02.2021 ka parashtruar kërkesë tek Njësia e personelit në Komunë të Ferizajt dhe Drejtori i Financave, për ngritje të koeficientit nga gjashtë (6) në koeficientin shatë(7) në raporte me kolegët me detyra të njëjta.

Ankuesi kundër heshtjes administrative të Komunës së Ferizajt, me datë 26.04.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, sipas kërkesës së datës 16.02.2021 me numër protokoll 02-12/04-0015183/21 drejtuar Njësia e personelit dhe Drejtori i Financave në Komunë të Ferizajt.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 05.05.2021 ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Ferizajt. Më datë 19.05.2021 Komuna e Ferizajt, ka dërguar përgjigjen në ankesë me provat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e regjistruar me datë 26.04.2021 e parashtruar nga ankuesi me numër protokoll 1994/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin



Civil të Kosovës, përmes postës së Kosovës me date 23.04.2021 me numër R1449620; Kërkesës së datës 16.02.2021 me numër protokoll 02-12/04-0015183/21 drejtuar Njësia e personelit dhe Drejtori i Financave në Komunë të Ferizajt; Kërkesës së datës 16.02.2021 me numër protokoll 03-615/03-0102207/20 drejtuar Njësia e personelit dhe Drejtori i Financave në Komunë të Ferizajt; Akte Emërimit të datës 01.07.2011; Përgjigje në ankesë e datës 19.05.2021 nr. protokoll 2462/2021; Akte përcjellës i datës 17.05.2021; Njofim i datës 17.05.2021 për KPMSHCK-së; Urdhëresë e datës 30.06.2011.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura në lëndë të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pa bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka analizuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili kundër heshtjes administrative të Komunës së Ferizajt, me datë 23.04.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër mos përgjigjes në kërkesë të datës 16.02.2021 me numër protokoll 02-12/04-0015183/21, për ngritje të koeficientit nga gjashtë (6) në koeficientin shtatë(7) në raporte me kolegët me detyra të njëjta, e cila ankesë është pranuar me datë 26.04.2021 përmes postës së Kosovës me numër R 1449620, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar me numër protokoll 1994/2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka administruar provat e lëndës ka konstatuar se ankuesi pretendon që ti bëhet ngritja e koeficientit nga gjashtë (6) në koeficientin shtatë (7) në raport me kolegët e tij me detyra të njëjta, ka konstatuar se dispozita ligjore e nenit 11 në paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrar Publik, ka përcaktuar funksionin e Ministrisë përgjegjëse për Administratën Publike me përgjegjësi për menaxhimin e zyrtarëve publikë, ku përcakton se: **‘1. Në kuadër të ministrisë përgjegjëse për administratën publike krijohet dhe funksionon Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë (me tej: DMZP), i cili ka këto përgjegjësi: 1.1. përgatit dhe mbikëqyr zbatimin e politikave për zyrtarët publikë; 1.2.mbikëqyr zbatimin e legjislacionit për zyrtarët publikë në institucionet e administratës shtetërore; 1.3. përgatit dhe mbikëqyr zbatimin e politikave për paga për zyrtarët publikë dhe funksionarët publikë’**, si dhe përgjegjësitë për zbatimin e këtij neni janë përcaktuar në paragrafin 2 të këtij nenin, ku është përcaktuar se: **‘2. Përgjegjësitë e përcaktuara në nën paragrafët 1.1 dhe 1.6 të këtij neni, për atë sa kanë të bëjnë me nëpunësit administrativ dhe mbështetës, kryhen në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjet e punës’**.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se pretendimi i ankuesit është i pa bazuar lidhur me faktin se në dispozitën ligjore të nenit 7 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, ka përcaktuar se: **‘1. Udhëheqësit e institucioneve të administratës publike ia propozojnë gradat e pozitive në institucionin e tyre ministrisë përgjegjëse për administratë publike, në bazë të rekomandimeve të personit përgjegjës për burime njerëzore në institucionin e tyre, i cili është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe procedurave për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. 2. Grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financat’**, dhe se ankuesi ka themeluar marrëdhënie të punës sipas Akte Emërim të datës 01.07.2011, me koeficientin gjashtë(6), andaj me dispozitën e lartë cekura nëpunësi civil gjegjësisht ankuesi, pagën e ka të përcaktuar konform Akte Emërim dhe e merr pagën siç e përcaktuar neni 9 paragrafi 1 i Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, ku përcakton se: **‘Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara në aktin e kontratës së punës’**, dhe se ankuesi është duke e ushtruar pozitën ‘Inspektor për Inkasim të Detyruar’, në Drejtorin për Ekonomi, Financa dhe Buxhet të përcaktuar në akt emërim. Mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankuesit është i pa bazuar se Komuna e Ferizajt nuk mund të bëjë ngritjen e koeficientit me vendim të brendshëm sipas kërkesës së ankueses pa bazë ligjore, pa planifikim të mjeteve buxhetore të miratuara nga Ministria përgjegjëse për Administratë Publike dhe Ministria



e Financave, si dhe pa miratim të Qeveria për grada për secilin pozitë të punës dhe ndryshimet e tyre, të përcaktuar në dispozitën e cekur si më lartë.

Lidhur me këtë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson se institucionet duhet të kenë parasysh që të ndërmarrin të gjitha veprimet ligjore që të gjithë nëpunësit civil për pozita të njëjtë të paguhen me pagë të njëjtë siç parashihet me nenin 3 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, i cili përcakton se: ***“Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë”***.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se ankuesi ka themeluar marrëdhënien e punës në Komunë të Ferizajt në pozitë “Inspektor për Inkasim të Detyruar”, në Drejtorin për Ekonomi, Financa dhe Buxhet, me koeficientin gjatë(6), sipas Akt emërimit të datë 01.07.2011 të karrierës pa afat, dhe pretendon ngritje të koeficientit në shtatë(7), lidhur me këtë pretendim baza ligjore e nenit 38 paragrafi 3 dhe 4 si dhe neni 39 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, ka përcaktuar lëvizjen brenda kategorisë dhe ngritjen në detyrë me procedurë konkurruese, siç përcaktohet se: ***“1 Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë”..... 3. Fillimi i procedurës së konkurrimit shpallet në afat jo më të shkurtër se 15 ditë nga data e caktuar për paraqitjen e aplikimit, në ueb faqen unike të procedurave të konkurrimit të SIMBNJ dhe me mjete të tjera të përshtatshme. 4. Procedura e përzgjedhjes është një procedurë konkurruese dhe organizohet nga Njësia e Burimeve Njerëzore e institucionit ku është pozita e lirë”, dhe neni 39 paragrafi “1. Nëse një pozitë e lirë e kategorisë së ulët apo e mesme drejtuese nuk është plotësuar sipas nenit 38 të këtij ligji, ajo hapet për procedurën e ngritjes në detyrë.3. Ngritja në detyrë realizohet nëpërmjet një procedure konkurruese të organizuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të institucionit, që ka pozitën e lirë”, dhe në rastin konkret ngritje e koeficientit në shërbimin civil bëhet në pajtim me procedurë konkurruese siç e përcaktojnë dispozitat e lartë cekura.***

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitave të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore/Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.Nr.302/2020, me datë 01.06.2021

Zylë Milaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Ferizajt
- Menaxherit të Personelit në Komunë të Ferizajt dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.